



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
FAKULTETI I GJUHËVE TË HUAJA
DEPARTAMENTI I GJUHËVE SLLAVE DHE
BALLKANIKE



PROGRAMI MËSIMOR I LËNDËS
Tipologji Tekstore I

Ngarkesa: 4 kredite; 40 orë mësimore; - leksione / 40 seminare
Viti / Semestri: Viti I , semestri II
Lloji i lëndës: Lëndë e detyrueshme
Programi i studimit: Bachelor – Gjuhë, Letërsi dhe Qytetërim Turk
Kodi i etikës: Kodi i etikës i UT-së (nenet 4, 6, 7, 9)

PËRMBLEDHJET DHE REZULTATET E TË NXËNIT:

Objektivat e përgjithshme lëndore: Të njihet me struktura të reja gramatikore me të cilat ndeshen në një tekst. Të arrijë nivelin gjuhësor të përcaktuar. Të punojë individualisht dhe në grup për të ushtruar rregullat gjuhësore të mësuara, për të punuar me fjalorin, me sinonimet, antonimet e fjalëve të tekstit, me shprehjet frazeologjike, etj.

Objektivat specifike lëndore:

1. Të mësojë të punojë me një tekst të caktuar
2. Të dallojë strukturat e reja gramatikore.
3. Të lexojë dhe të kuptojë tekstet e përzgjedhura.
4. T'u përgjigjet saktë pyetjeve në lidhje me tekstet e përzgjedhura

Rezultate të pritshme:

1. Studentët do të jenë në gjendje të kuptojnë dhe të analizojnë tekste të ndryshme autentike, duke identifikuar strukturat gramatikore, fjalorin tematik dhe funksionin e secilit tekst sipas tipologjisë përkatëse.
2. Do të përvetësojnë fjalor të ri dhe shprehje frazeologjike, të cilat do t'i përdorin në mënyrë të saktë dhe funksionale në të shkruar dhe në të folur.
3. Do të zhvillojnë dhe konsolidojnë aftësitë e të lexuarit me kuptim dhe të të shprehurit në mënyrë të saktë dhe të rrjedhshme, në përputhje me nivelin gjuhësor të përcaktuar nga Kuadri Europian i Referencës për Gjuhët.